



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202200151/13

Tiranë ___/___/2022

Lënda : *Informacion dhe kopje të dokumenteve lidhur me shtetasin A.A.*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
Tiranë

Me shkresat nr. K2/A5-3 prot., datë 16.02.2022, nr. K2/A5-6 prot., datë 17.03.2022 dhe nr. K2/A5-9 prot., datë 06.04.2022, ju kemi vënë në dijeni se në institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi A.A., i biri i K. dhe i D., lindur më 02.07.1996 në Çorovodë, Skrapar dhe banues në Mbrakull, Poliçan. Ankuesi shkruan se pas shpalljes së vendeve vakante për ndjekjen e studimeve në Akademinë e Sigurisë për "Patrullën e Përgjithshme" nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në muajin shtator 2021 dhe meqënëse i plotësonte kriteret ligjore, ai ka aplikuar në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat ku ka dorëzuar edhe dokumentacionin përkatës. Sipas ankuesit, gjatë procesit të testimave të bëra nga Akademia e Sigurisë, si testi me shkrim, ai fizik, kontrolli mjekësor dhe testi logjik, ai ka rezultuar fitues për të vazhduar shkollimin/kursin për "Patrullën e Përgjithshme".

Ndërkohë që ishte në pritje për të filluar shkollën, në datën 14.02.2022, ai është njoftuar në telefon nga Shefi i Stacionit të Policisë Poliçan se kandidatura e tij ishte skualifikuar sepse nuk përmbushte kriterin e besueshmërisë për të qenë student i Akademisë së Sigurisë. Gjithashtu ai është informuar se shkak i skualifikimit të tij është një vendim gjyqësor i dhënë nga një gjykatë e shtetit të Maqedonisë së Veriut në vitin 2018, sipas të cilit ai është dënuar me 3 muaj burgim për veprën penale të vjedhjes dhe 3 vjet ndalim hyrjeje në këtë shtet.

Ankuesi pretendon se shkak i skualifikimit të tij për të vazhduar shkollimin në Akademinë e Sigurisë për "Patrullë të Përgjithshme" është i pa vërtetë, sepse ai, jo vetëm

që nuk ka kryer veprën penale të vjedhjes dhe nuk është dënuar penalisht nga gjykatat e këtij shteti, por sipas tij, ai nuk ka qenë asnjëherë në shtetin e Maqedonisë së Veriut si në rrugë legale ashtu edhe në rrugë ilegale duke kaluar kufirin në mënyrë të kundërligjshme jashtë pikave të kalimit kufitar.

Për këto arsye ai kërkon ndërhyrjen e institucionit tonë pranë institucioneve publike shqiptare për të bërë të mundur verifikimin e pretendimeve të tij se shkak i skualifikimit për të vazhduar Akademinë e Sigurisë nuk është i vërtetë sepse ai jo vetëm që nuk ka kryer veprën penale të vjedhjes dhe dënuar penalisht me burgim në shtetin e Maqedonisë së Veriut, por nuk ka shkelur kurrë në territorin e këtij shteti. Gjithashtu ai kërkon që pas verifikimit të pretendimeve të tij, t'i jepet mundësia për të vazhduar Akademinë e Sigurisë për t'u bërë punonjës i Policisë së Shtetit sepse i plotëson të gjitha kriteret ligjore, duke përfshirë edhe atë të besueshmërisë.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, ju kërkuam që të na dërgoni një informacion dhe fotokopje të dokumentacionit që administrohet nga ana juaj në ngarkim të shtetasit A.A. në bazë të cilit ai është skualifikuar nga e drejta për të vazhduar Akademinë e Sigurisë.

Me shkresën nr. 211/7-A prot., datë 31.03.2022, ndërmjet të tjerave na informuat se, shtetasi A.A. ka aplikuar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Berat për konkurrim për pranimin në Akademinë e Sigurisë. Ai është kualifikuar në fazat e konkurrimit: Testim me shkrim, testimi fizik, intervista me gojë dhe testimi psikologjik.

Më pas ai i është nënshtruar verifikimit mbi plotësimin e kriterit ligjor të besueshmërisë, bazuar në nenin 38/2/f të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, si dhe në nenin 139 të Rregullores së Policisë së Shtetit, të miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015, që ka të bëjë me verifikimin e të dhënave nga strukturat e policisë kriminale për të dokumentuar faktin që konkurrenti ose pjestarët e familjes së tij nuk janë të implikuar në veprimtari kriminale.

Nga verifikimi kryer nga strukturat e policisë kriminale ka rezultuar se shtetasi A.A. ***nuk plotëson kriterin ligjor të besueshmërisë*** për pranimin në Akademinë e Sigurisë, pasi në sistemet e Policisë së Shtetit rezulton me të dhëna, si person i dënuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut me tre muaj burgim për veprën penale të vjedhjes, si dhe tre vite për të mos shkelur në këtë shtet.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 140/1/g të Rregullores së Policisë së Shtetit, ku parashikohet rasti i skualifikimit "***Nuk gëzon besueshmëri për të qenë në radhët e Policisë së Shtetit***", ai është skualifikuar nga procesi për pranimin në Akademinë e Sigurisë me vendimin nr. 203, datë 15.02.2022 të Komisionit të Pranimit.

Ndërsa me shkresën nr. 211/10-A prot., datë 19.04.2022, ndërmjet të tjerave na informuat se:

“Ky shtetas rezulton me të dhëna si person i dënuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut me 3 muaj burg për veprën penale të vjedhjes, si dhe me 3 vjet për të mos shkelur në këtë shtet.

Policia e Shtetit nuk disponon vendimin e gjykatës së shtetit të Maqedonisë së Veriut, por informacioni mbi dënimin e shtetasit A.K.A. në këtë shtet, është dhënë nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Shkup/Maqedoninë e Veriut, në muajin Qershor 2018. Informacioni është i regjistruar në sistemin MEMEX që administron Policia e Shtetit.

Gjithashtu në këtë shkresë u informuam se, nga verifikimet në sistemin TIMS nuk rezulton që shtetasi A.K.A. të këtë kaluar kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë për në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në vijim të ndjekjes së kësaj ankese, ne i jemi drejtuar edhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Kjo ministri, nëpërmjet Drejtorisë së Çështjeve Konsullore me shkresën nr. 2100/1 prot., datë 30.03.2022, na informoi se në bazë të konfirmimit me Notë të Ministrisë së Jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dërguar Ambasadës tonë në Shkup, rezulton se ndaj shtetasit A.K.A., i datëlindjes 02.07.1996, lindur në Çorovodë ***nuk ka pasur ndonjë kallëzim penal apo filluar ndonjë procedim penal, deri në datën e dërgimit të këtij dokumenti.***

Bashkëlidhur me informacionin kjo ministri na dërgoi përgjigjen e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Shkup dërguar Drejtorisë së Çështjeve Konsullore pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Fotokopjet e këtyre dokumenteve na jua dërguam me shkresën e fundit të cituar më sipër.

Meqënëse u ndodhëm para dy informacioneve të ndryshme lidhur me shtetasin A.K.A. të cilat i parashtruam më lart, i kërkuam Drejtorisë së Çështjeve Konsullore në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme verifikimin e këtij rasti nëpërmjet Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Shkup dhe dërgimin e një informacioni shtesë lidhur me sa më poshtë:

1. Cili nga informacionet e parashtruara më sipër është i saktë, ai që na ka dërguar Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën nr. 211/10-A prot., datë 19.04.2022, sipas të cilit ***shtetasi A.K.A. rezulton me të dhëna si person i dënuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut me 3 muaj burg për veprën penale të vjedhjes, si dhe me 3 vjet për të mos shkelur në këtë shtet***, apo ai që na ka dërguar Drejtoria e Çështjeve Konsullore e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën nr. 2100/1 prot., datë 30.03.2022, sipas të cilit rezulton se ***ndaj shtetasit A.K.A, i datëlindjes 02.07.1996, lindur në Çorovodë nuk ka pasur ndonjë kallëzim penal apo filluar ndonjë procedim penal, deri në datën e dërgimit të këtij dokumenti.***

2. A është i vërtetë fakti i referuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit se informacioni mbi dënimin e shtetasit A.K.A. në Maqedoninë e Veriut i është dhënë nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Shkup/Maqedoninë e Veriut, në muajin Qershor 2018. Nëse po, lutemi të na dërgoni një kopje të këtij informacioni.

Me shkresën nr. 6106/1 prot., datë 16.05.2022, Drejtoria e Çështjeve Konsullore na dërgoi informacionin e ambasadës tonë në Shkup, sipas të cilit njoftimi i autoriteteve maqedonase me Notë dërguar ambasadës tonë më 21.05.2018 bën fjalë për shtetasin **A.A., i datëlindjes 15.03.1994, lindur në Tiranë, i dënuar me 3 muaj burgim për vjedhje dhe 3 vjet ndalim të hyrjes në RMV, i pajisur me pasaportën shqiptare Nr. BB8495985.**

Bashkëlidhur na dërgoi edhe kopje të dy informacioneve konfirmuese të ambasadës tonë në Shkup dhe të Notave të MPJ të RMV dërguar ambasadës tonë atje në gjuhën maqedonase.

Nisur nga këto dy informacione, kjo drejtori na sugjeron t'ju kërkojmë të verifikoni nëse pasaporta shqiptare me Nr. BB8495985 i përket shtetasit A.A. apo shtetasit A.A. dhe nëse bëhet fjalë për të njëjtin person.

Pavarësisht sugjerimit të cituar më sipër, sqarojmë se nga përmbajtja e kopjeve të dy informacioneve konfirmuese të ambasadës tonë në Shkup dhe të Notave të MPJ të RMV dërguar ambasadës tonë atje në gjuhën maqedonase konstatojmë se:

a) Shtetasi i dënuar për vjedhje nga gjykata e RMV me 3 muaj burgim dhe 3 vjet ndalim të hyrjes në RMV është A.A., i datëlindjes 15.03.1994, lindur në Tiranë dhe mbajtës i pasaportës Nr. BB8495985 dhe jo A.A..

b) Ankuesi me përjashtim të emrit që ka të njëjtë me personin e përmendur më sipër, gjeneralitetet e tjera i ka të ndryshme nga ato që i përkasin shtetasit A.A., sikurse janë: mbiemri A., datëlindja 02.07.1996, vendlindja Çorovodë, atësia K. dhe është mbajtës i pasaportës me Nr. BC2916816, e cila është lëshuar në datën 21.09.2016 dhe është e vlefshme deri më 20.09.2026.

c) Sikurse konfirmoni vetë ju, nga verifikimet në sistemin TIMS nuk rezulton që shtetasi A.K.A. të këtë kaluar kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë për në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Nga sa më sipër rezulton se, informacioni i regjistruar në sistemin MEMEX që administron Policia e Shtetit mbi dënimin e shtetasit A.K.A., i datëlindjes 02.07.1996, lindur në Çorovodë në RMV është i pasaktë dhe ka ardhur për shkak të pakujdesisë së punonjësve që e kanë regjistruar atë në sistem.

Ndërkohë me keqardhje konstatojmë se, ndonëse ky gabim është bërë nga punonjësit e organit tuaj, por nga ana juaj nuk është ndërmarrë asnjë veprim verifikues referuar

dokumentacionit të dërguar organit tuaj si dhe institucionit tonë nga ambasada jonë në Shkup.

Ky gabim i bërë nga ana juaj ka sjellë si pasojë cënimin e të drejtës së shtetasit A.A. për t'u shkolluar në Akademinë e Sigurisë dhe punësuar në Policinë e Shtetit.

Pavarësisht konkluzionit të arritur nga ana jonë, ju kërkohet që për të krijuar bindjen e plotë të verifikoni edhe faktin nëse pasaporta shqiptare me Nr. BB8495985 i përket shtetasit A.A. apo shtetasit A.A. dhe nëse A.A. dhe A.A. është apo jo i njëjti person.

Nëse edhe nga ky verifikim që do të bëni do të rezultojë se shtetasi A.K.A., i datëlindjes 02.07.1996, lindur në Çorovodë, nuk është personi që është dënuar në RMV, atëherë atij t'i jepet mundësia për të vazhduar studimet në Akademinë e Sigurisë për "Patrullën e Përgjithshme" në kursin e ardhshëm.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni lidhur me këtë rast, na vini në dijeni sa më parë.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë fotokopje të shkresës nr. 6106/1 prot., datë 16.05.2022, dërguar institucionit tonë nga Drejtoria e Çështjeve Konsullore, të dy informacioneve konfirmuese të ambasadës tonë në Shkup dhe të dy Notave të MPJ të RMV dërguar ambasadës tonë Shkup në gjuhën maqedonase, si dhe të pasaportës së shtetasit A.A..

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi